



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALËSI E MADHE  
KRYETARI

Nr. prot 1289

VENDIM  
Nr. 50, datë 06/2024

**“PËR NDËRMARRJEN E NISMËS SË RISHIKIMIT TË DOKUMENTIT TË PLANIT  
TË PËRGJITHSHËM VENDOR BASHKIA MALËSI E MADHE ME PROCEDURË TË  
THJESHTUAR”**

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vndore”, i ndryshuar, në nenin 13 pika Ishkronja (b), në nenin 26 të ligjit Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, në nenin 11 dhe 12 të VKM 686/2017 “Per miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, i ndryshuar, Kryetari i Bashkisë,

**Vendosi:**

1. Të ndërmarrë nismën për rishikimin e dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor me procedurë të thjeshtuar, për ato çështje dhe kërkesa të cilat:
  - Janë në përputhje dhe nuk bien në kundërshtim me legjislacionin sektorial në fushën e mjadisit, zonave të mbrojtura, trashëgimisë historike dhe kulturore, duke mos cënuar vlerat e tyre;
  - Janë në përputhje, nuk bien në kondërshtim dhe nuk ndryshojnë dokumentin e Strategjisë Territoriale;
  - Vijnë si pasojë e konstatimit të gabimeve emospërputhjeve në dokumentin e Planit dhe mes pjesëve përbërëse të tij, si dhe mes Planit dhe gjendjes faktike në territor,
  - Vijnë si pasojë e forcave madhore si: tërmete, përmytje, zjarre masive, rrëshqitje të tokës, erozion, etj., të ngjashme, për shkak të ndarjeve administrative e territoriale, ndryshimeve të paparashikuara demografike, sociale e ekonomike, ndryshimeve të shkaktuara nga kriza sektoriale,

- Vijnë si nevojë për harmonizimin me dokumente të një niveli më të lartë planifikimi apo me ndryshime të kuadrit ligjor në fushën e mbrojtjes e të menaxhimit të territorit, si dhe për arsye të përafritimit me legjislacionin e Bashkimit European.

2. Pjesë integrale e këtij vendimi është dokumenti i nismës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Urban, Projekteve dhe Kadastrës pranë Bashkisë Malësi e Madhe.
4. Vendimi për miratimin e Nismës dhe Dokumenti i Nismës botohen në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e miratimit.

**KRYETAR**

**TONIN MARINAJ**

